

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ELITE DENTAL” Shpk

Ortakët themelues si më poshtë:

- **Znj. Etleva Dema**, shtetase shqiptare, e bija e Sazan, e datëlindjes 11.01.1982, lindur në Sarandë dhe banuese në adresën :Rruga Sheh Ahmet Pazari, Ambasador 3 kati 16 ap 123, Tiranë Shqipëri, mbajtës i katrës identitetit nr. I25111050V.
- **Z. Artdur Dema**, shtetas shqiptar, i biri i Petritit i datëlindjes 01.07.1980, lindur në Krujë dhe banues në adresën: Rruga Sheh Ahmet Pazari, Ambasador 3 kati 16 ap 123, Tiranë Shqipëri, mbajtës i kartës identitetit nr.I00701067R.

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, sot më datë 01.05.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon.

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare mban emrin “ELITE DENTAL” Shpk.
Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare “ELITE DENTAL” Shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ELITE DENTAL” Shpk, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën:

Rr Stavri Vinjau 2 (ne krah te Ambasades Amerikane) - Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

4.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si vijon:

- 1) Klinike dentare
- 2) Laborator dentar
- 3) Veprimtari me burime te rrezatimeve jonizuese-gjeneratore me rreze x



NENI 5
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “ELITE DENTAL” Shpk do të jetë 99 vjet.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “ELITE DENTAL” Shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “ELITE DENTAL” Shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ELITE DENTAL” Shpk është 10,000 (dhjetëmijë) lekë, i gjithi i nënshkruar dhe i shlyer prej ortakëve.

8.2 Ortakët kanë kontribuar dhe zotërojnë në kapitalin e shoqërisë kuotat si më poshtë:

- Znj. Etleva Dema, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 4,900 (katërmijëenëntëqind) lekë, e cila përbën 49% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Artdur Dema, është zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 5,100 (pesëmijëcnjëqind) lekë, e cila përbën 51 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Znj. Etleva Dema**.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “ELITE DENTAL” Shpk përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.




NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT THEMELUES

ETLEVA DEMA

Etleva Dema 

ARTDUR DEMA

ARTDUR DEMA 